



Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
Sheshi *Fan Noli*, nr. 7  
Tiranë - Shqipëri

## Protokoll

### Për zbatimin e *Marrëveshjes* së bashkëpunimit kërkimor shkencor dhe artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

(Për periudhën 2024-2025)

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (më tej: ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), të quajtura në vijim *Palë*, me qëllim që të vazhdojnë të zhvillojnë traditën e bashkëpunimit të frytshëm kërkimor-shkencor mes tyre, pas bisedimeve dhe shkëmbimit të mendimeve për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërinstitucionale në përfundim të periudhës së protokollit për vitet 2022-2023, nënshkruajnë këtë *Protokoll bashkëpunimi* për periudhën 2024-2025, duke mbajtur parasysh rëndësinë e ndërmarrjes së nismave të përbashkëta shkencore nga të dyja *Palët*, të shkëmbimit të kërkuesve, përvojave dhe informacionit shkencor, mbështetur në *Marrëveshjen-kuadër* të nënshkruar ndërmjet tyre.

1. *Palët* bien dakord që veprimtaritë e përbashkëta të tyre për periudhën 2024-2025 (nisma shkencore, konferenca, botime, projekte); kalendari, vendi i zhvillimit dhe strukturat e ngarkuara për t'i ndjekur në zbatim të jenë si në pasqyrën në vijim:

Nr .	Projekte madhore	Vendi	Koha	Përgjegjës
1.	<i>Enciklopedia shqiptare</i>	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK

2.	<i>Fjalor i madh i gjuhës shqipe (recensim, redaktim)</i>	Tiranë-Prishtinë	2024	ASHSH
3.	<i>Histori e shqiptarëve (në tre vëllime, shqip e anglisht) recensim, redaktim</i>	Tiranë-Prishtinë	2024	ASHSH
<b>Aktivite kryesore</b>				
1.	Konferencë shkencore ndërkademiike: <i>Përkthyesit pa emër: si është përdorur dhe si po përdoret vepra e tyre</i>	Tiranë	2025	ASHSH-ASHAK
2.	Konferencë shkencore ndërkombëtare: <i>Për krijimtarinë e Shtjefën Gjeçovit (në 150-vjetorin e lindjes)</i>	Prishtinë	2024, tetor	ASHAK-ASHSH
3.	Konferencë shkencore ndërkombëtare <i>kushtuar 100-vjetorit të revolucionit të qershorit (1924)</i>	Tiranë	2024	ASHSH-ASHAK
4.	Konferencë shkencore kushtuar <i>80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë e të fitores antifashiste</i>	Tiranë	2024	ASHSH-ASHAK
5.	Konferencë shkencore kushtuar <i>80-vjetorit të Konferencës së Bujanit</i>	Prishtinë	2024	ASHAK-ASHSH
6.	Konferencë shkencore kushtuar <i>200-vjetorit të ndarjes nga jeta të Bajronit</i>	Tiranë	2024	ASHSH-ASHAK
7.	Konferencë shkencore: <i>Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon (II)</i>	Tiranë	2025	ASHSH-ASHAK
8.	Konferencë shkencore: <i>25-vjetori i ndërhyrjes së NATO-s dhe çlirimit të Kosovës: një çerek shekulli shtetndërtim, sfida dhe arritje - qasje multidisiplinare</i>	Prishtinë	2024	ASHAK-ASHSH

9.	Konferencë shkencore: <i>Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar (1912-2024)</i>	Prishtinë	2024	ASHAK-ASHSH
10.	Konferencë ndërkombëtare për matematikën	Tiranë	2025	ASHSH-ASHAK
11.	Konferencë shkencore ndërkombëtare: <i>Ndryshimet klimatike, resurset ujore dhe trajtimi i ujërave të ndotura</i>	Prishtinë-Tiranë	2024-2025	ASHAK-ASHSH
12.	Tryezë shkencore dhe botim me rastin e 90-vjetorit të lindjes së Ali Aliut	Prishtinë-Tiranë	2024, prill	ASHAK-ASHSH
13.	Tryezë shkencore: <i>Vepra e At Zef Pllumit, në 100-vjetorin e lindjes</i>	Tiranë	2024	ASHSH-ASHAK
14.	Tryezë shkencore: <i>Mbretëria dardane dhe periudha e kalimit nga dardanët tek arbërit mesjetarë në territorin e Kosovës</i>	Prishtinë	2025	ASHSH-ASHAK
15.	Tryezë shkencore: <i>Politikat e shpopullimit pas Luftës II Botërore dhe qëndresa kombëtare në Kosovë</i>	Tiranë	2025	ASHSH-ASHAK
16.	Simpozium shkencor: <i>Burimet alternative të energjisë së ripërtëritshme, kapacitete, teknologjitë dhe legjislacioni</i>	Tiranë	2024	ASHSH
	<b>Projekte/studime dhe botime</b>			
1.	<i>Gjendja dhe kontributi i shkencave ekonomike në Kosovë dhe në Shqipëri</i>	Tiranë-Prishtinë	2024	ASHSH-ASHAK
2.	<i>Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Kosovë-Shqipëri</i>	Prishtinë-Tiranë	2024	ASHAK-ASHSH
3.	<i>Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhe satelitore, përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera</i>	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK

4.	<i>Studimi i mikrozonimit sizmik dhe kategorizimi sizmik i trojeve të qytetit të Tiranës dhe Prishtinës për qëllime të mbrojtjes civile</i>	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
5.	<i>Kërkime në gjenetikë, studim dhe konferencë ndërkombëtare</i>	Tiranë	2025	ASHSH-ASHAK
6.	<i>Për gjenetikën e popullatës shqiptare</i>	Tiranë	2024	ASHSH-ASHAK
7.	<i>Studim për burimet alternative të energjisë</i>	Tiranë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
8.	<i>Botim fjalorësh terminologjikë dhe frazeologjikë</i>	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
	<b>Aktivitete të tjera të bashkëpunimit</b>			
1.	Nxitja e bashkëpunimit për projekte të përbashkëta studimore në infrastrukturë, pasuri minerare, ekologji	Prishtinë-Tiranë	2024-2025	ASHAK-ASHSH
2.	Bashkëpunim për ngritjen e qendrave kërkimore në fusha të reja: robotikë, inteligjencë artificiale, bioteknologji, nanoshkencë dhe energjetike	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
3.	Panairi i botimeve shkencore dhe akademike shkencore	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
4.	Nderimi i figurave kryesore shkencore dhe akademike të <i>Palëve</i>	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
5.	Vazhdimi i punës për një platformë të përbashkët për një qasje të hapur në botimet dhe periodikët shkencorë	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
6.	Koncerte dhe ekspozita të përbashkëta me vepra të kompozitorëve dhe artistëve të Shqipërisë dhe Kosovës	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
7.	Bashkëpunim profesional ndërbibliotekar:	Tiranë-Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore dhe artistike të <i>Palëve</i>;</li> <li>- Botime të ndërsjella e promovime të rezultateve kërkimore shkencore dhe artistike;</li> <li>- Katalogimi <i>online</i> i fondeve albanologjike;</li> <li>- Përgatitje dhe botim <i>online</i> të bibliografive vetjake të kërkuesve shkencore, përrurim i tyre;</li> <li>- Shkëmbim eksperience për digjitalizimin e informacionit shkencor.</li> </ul>			
--	---	--	--	--

2. Për çdonjëren prej veprimtarive të parashikuara *Palët* hartojnë dhe miratojnë programin e posaçëm shkencor të punës, që miratohet prej tyre në përputhje me procedurat që zbatohen. Programi i punës propozohet nga *Pala pritëse* e veprimtarisë.
3. Veprimtaritë që përmban pasqyra më sipër *Palët* i përfshijnë në kalendarët vjetorë të punës së tyre.
4. Këtij *Protokoll* mund t'i bëhen shtesa dhe ndryshime gjatë procesit të zbatimit, varësisht prej dinamikës së përparësive dhe mundësive financiare të *Palëve*. Propozimet për shtesa a ndryshime bëhen me shkrim nga *Palët* dhe shqyrtohen për miratim brenda një periudhe tremujore. *Palët* bashkëpunojnë edhe jashtë zotimeve të këtij *Protokoll*.
5. Shpenzimet e udhëtimit të drejtuesve të *Palëve* në funksion të zbatimit të këtij *Protokoll* janë të *Palës udhëtuese*, kurse shpenzimet e akomodimit të *Palës pritëse*. Kjo është e vlefshme edhe për pjesëmarrjet në veprimtari shkencore, përveç rasteve kur merren vesh ndryshe.
6. Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë *Protokoll* përfaqësues të *Palëve* takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit caktohen me marrëveshje rast pas rasti, me letërkëmbim.
7. *Protokoll* u nënshkrua në Tiranë më 11.10.2023, në dy kopje, në gjuhën shqipe. Ky *Protokoll* hyn në fuqi më 1 janar 2024.

Për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Akad. Mehmet Kraja, Kryetar



Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar

